



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 483 Akti

Nr. 562 Vendimi  
Tiranë, më 16.9.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Xhensila Pine</b>	Kryesuese
<b>Firdes Shuli</b>	Relatore
<b>Olsi Komici</b>	Anëtar

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 16.9.2022, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Bedri Qori**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;  
**Neni G** i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;  
**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;  
**Ligji nr. 96/2016**, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;  
**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;  
**Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017**, i Gjykatës Kushtetuese.

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Pika 3, e nenit 179/b, të Kushtetutës parashikon se procesit të rivlerësimit i nënshtrohen të gjithë gjyqtarët e Republikës së Shqipërisë.

2. Z. Bedri Qori, për shkak të funksionit të tij si gjyqtar, i nënshtrohet automatikisht procesit të rivlerësimit *ex officio*.

3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në datën 15.6.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, zhvilloi procedurat e shpërndarjes së çështjeve me short, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Bedri Qori, do t’i nënshtrohej procesit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Xhensila Pine, Olsi Komici dhe Firdes Shuli. Relator i çështjes me short u zgjodh komisionere Firdes Shuli.

4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin e datës 24.6.2020, vendosi fillimin e hetimit administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues komisioneren Xhensila Pine. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Në datën 22.7.2020, subjekti i rivlerësimit, u njoftua përmes postës elektronike, mbi fillimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, si dhe përbërjen e trupit gjykues, për të cilin, nëpërmjet komunikimit elektronik të po kësaj date, deklaroi se nuk konstatonte gjendje konflikti interesi me asnjë nga anëtarët e tij.

6. Në datën 12.7.2022, subjekti i rivlerësimit i kërkoi Komisionit përmes postës elektronike pezullimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të tij dhe, pas verifikimit të kushteve ligjore, ndërprerjen e procedurës së rivlerësimit për shkak të dorëheqjes, për arsye se në datën 7.7.2022 kishte depozituar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor kërkesën për heqjen dorë nga statusi i magjistratit. Sipas tij, arsyet e heqjes dorë nga statusi i magjistratit ishin: ngarkesa në rritje e punës; plotësimi i vjetërsisë në punë prej më tepër se 35 vjet; si dhe gjendja jo e mire shëndetësore.

7. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.7.2022, i ka përcjellë Komisionit vendimin nr. \*\*\*, datë 19.7.2022, me anë të të cilit ka vendosur: (i) deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. Bedri Qori, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të dorëheqjes së tij; (ii) efektet e këtij vendimi fillojnë në datën 31.8.2022; (iii) një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit Bedri Qori, sipas kërkesave ligjore; (iv) kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

8. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.9.2022, Komisioni iu drejtua me kërkesë për informacion Gjykatës Administrative të Apelit, nëse ndaj këtij vendimi ishte ushtruar ankim. Në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.9.2022, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë informoi Komisionin se ndaj këtij vendimi nuk rezultoi të ishte ushtruar ankim.

## **II. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT**

9. Procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar në respektim të pikës 4, fjalia e parë e nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

10. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara më lart, konstaton se:

- i. subjekti i rivlerësimit Bedri Qori ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese që parashikuan procesin e rivlerësimit dhe ligjin nr. 84/2016;
- ii. subjekti i rivlerësimit Bedri Qori ka paraqitur kërkesë për dorëheqje nga detyra e gjyqtarit në datën 7.7.2022, pra, pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese dhe ligjit nr. 84/2016;
- iii. KLGJ-ja, me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.7.2022, ka vendosur deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. Bedri Qori, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të dorëheqjes së tij;
- iv. ndaj vendimit nr. \*\*\*, datë 19.7.2022, të KLGJ-së nuk është ushtruar ankim.

**11.** Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon: *“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet. 2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.*

**12.** Neni 56 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka parashikuar të drejtën e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, si vijon: *“1. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit. 2. Pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të përfitojë pagesë kalimtare, sipas nenit 7, pika 1, të ligjit “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”.*

**13.** Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, ka interpretuar, ndër të tjera, lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave, si vijon: *“[...] Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës [...]”.*

**14.** Kolegji i Posaçëm Apelimit, në lidhje me praktikën e gjykimit të çështjeve që lidhen me institutin e dorëheqjes së subjekteve të rivlerësimit nga procesi në fazën e ndryshme të tij, po kështu edhe pasojat juridike që sjell ndërprerja e procesit, orienton Komisionin që për zgjidhjen e këtyre çështjeve, duke respektuar parimin e transparencës në zhvillimin e procedurës së rivlerësimit, të verifikojë vullnetin e pavesuar për dorëheqjen e dhënë, e cila duhet të ketë burim të ligjshëm një prej institucioneve të caktuara me ligj.

**15.** Në momentin që subjekti i rivlerësimit, me vullnetin e tij të lirë, ndërpret detyrën funksionale që e bën atë subjekt të procesit të rivlerësimit *ex officio*, duhet të marrë parasysh edhe pasojën ligjore që sjell dorëheqja nga detyra në ecurinë e procesit të rivlerësimit, sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës. Në të njëjtën frymë arsyeton edhe Gjykata Kushtetuese në

vendimin nr. 78, datë 12.12.2017, ku shprehet: “Gjykata thekson se për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës”.

**16.** Për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtës së subjektit për t’u dëgjuar, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në datën 7.9.2022, informoi subjektin nëpërmjet postës elektronike, mbi të drejtën për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore dhe se fokusi i kësaj seance do të jetë përfundimi i procesit të rivlerësimit, sipas nenit G, paragrafët 1 dhe 2, të Aneksit të Kushtetutës. Në datën 12.9.2022, subjekti i rivlerësimit njoftoi Komisionin me anë të postës elektronike se nuk dëshiron të ushtrojë të drejtën për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore, duke rikonfirmuar edhe një herë vullnetin e tij të lirë në lidhje me dorëheqjen.

**17.** Në këto kushte, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeh Kushtetuta dhe ligji për dorëheqje nga detyra e gjyqtarit. Në këtë kuptim, trupi gjykues arrin në përfundimin se për sa kohë dorëheqja e subjektit të rivlerësimit përmbush kriteret e përcaktuara në nenin G të Aneksit të Kushtetutës, atëherë pasoja juridike që i atribuohet situatës faktike të parashikuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës do të duhet të zbatohet në tërësinë e saj, duke i kufizuar të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

**18.** Ky është një qëndrim i unifikuar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në vendimmarrje të mëparshme, sipas të cilave orientohet Komisioni që, përveç ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, të vendosë edhe ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit, sipas nenit G, pika 2, e Aneksit të Kushtetutës.

**19.** Ndërprerja e procesit të rivlerësimit, për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Bedri Qori.
2. Ndalimin e emërimit të z. Bedri Qori, si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

3. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
U shpall në Tiranë, më 16.9.2022.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Xhensila PINE**  
**Kryesuese**

**Firdes SHULI**  
**Relatore**

**Olsi KOMICI**  
**Anëtar**

*Sekretare gjyqësore*  
*Ertugena Sokoli*